



Komuna e Fushë- Kosovës
Opstina Kosove Polje
Municipality of Fushe Kosova



PLANI I PRIORITETEVE

Përmbledhje ekzekutive

Qeveria e Kosovës ka miratuar “Strategjinë për Përfshirjen e komuniteteve Rom dhe Ashkali në Shoqërinë Kosovare 2017-2022” e cila është vazhdimësi e Strategjisë së ngjashme për periudhën 2009-2015. Strategjia parasheh masa dhe veprime konkrete për të siguruar përfshirjen e plotë të komuniteteve rom dhe ashkali në shoqërinë kosovare. Këto masa dhe veprime, krahas institucioneve të nivelit qendror, duhet të zbatohen edhe nga niveli lokal. Prandaj, me qëllim të adresimit të plotë dhe efikas të Strategjisë, komuna duhet të hartojë plane lokale të prioriteteve për përfshirjen e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptianë.

Komuna e Fushë Kosovës, me përkrahjen e Programit për të Drejtat Civile (CRP/K) dhe PORADNA-as, ka iniciuar procesin e hartimit të Planit të Prioriteteve për përfshirjen sociale të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Komunën e Fushë Kosovës 2018-2021. Qëllimi i këtij dokumenti është identifikimi i masave dhe veprimeve që Komuna e Fushë Kosovës duhet t’i ndërmerret me qëllim të sigurimit të përfshirjes së plotë në shoqëri të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.

Në mesin e shumë problemeve me të cilat ballafaqohen komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në komunën e Fushë Kosovës, Komiteti Komunal i Veprimit (MAC) për hartimin e Planit të Prioriteteve për Përfshirjen e Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Komunën e Fushë Kosovës 2019-2022 ka vendosur që në kuadër të këtij plani lokal të veprimit të përfshihen katër fushat si në vijim:

- Arsimi’
- Punësimi dhe mirëqenia sociale
- Shëndetësia
- Banimi

Komiteti Komunal i Veprimit (MAC) ka përcaktuar objektivat dhe aktivitetet e këtij plani të veprimit. Njëkohësisht, për të gjitha fushat e përfshira në këtë plan është bërë analiza e gjendjes, janë identifikuar sfidat kryesore, janë përcaktuar objektivat strategjikë, janë përcaktuar rezultatet e pritshme, si dhe janë caktuar dhe përshkruar aktivitetet e parapara, realizimi i të cilave do të ndikojë në përmirësimin e situatës së përgjithshme të këtyre komuniteteve në komunën e Fushë Kosovës. Po ashtu, janë përcaktuar edhe treguesit për secilin objektiv, si dhe është bërë një identifikim dhe përshkrim i supozimeve dhe rreziqeve që ndikojnë në zbatimin e këtij plani të prioriteteve. Shpenzimet për zbatimin e plotë të

aktiviteteve të parapara me Planini e Prioriteteve për Përfshirjen e Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Komunën e Fushë Kosovës parashihet të mbulohen nga buxheti i Komunës së Fushë Kosovës në përputhje me mundësitë financiare të saj, nga donatorë të ndryshëm si dhe nga institucionet qendrore të Kosovës.

2. Metodologjia

Procesi i hartimit të “Planit të prioriteteve për Përfshirjen e Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Komunën e Fushë Kosovës është përcjellë me mjaft sfida. Gjithnjë sipas të dhënave jozyrtare, edhe numri i qytetarëve të komunitetit rom në Komunën e Fushë Kosovës është më i lartë. Mospërputhja e të dhënave të regjistrimit të popullsisë me numrin real të banorëve në Komunën e Fushë Kosovës vazhdimisht ka sjellë sfida të mëdha për udhëheqësinë ekomunës. Problemet kryesisht ndërlidhen më buxhetin e zvogëluar të cilin e merr Komuna e Fushë Kosovës nga granti i përgjithshëm. Problemi financiar më tej shndërrohet në mungesë të burimeve njerëzore për ushtrimin e plotë të kompetencave komunale dhe në mungesë të kapaciteteve për trajtim efikas të kërkesave të qytetarëve. Plani i prioriteteve për përfshirjen e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptianë në Komunën e Fushë Kosovës është hartuar në përputhje me sugjerimet, kërkesat dhe kontributet e përfaqësuesve të ndryshëm nga Komuna e Fushë Kosovës, të caktuar nga komuna, zyrtarë të drejtorive të ndryshme komunalesi dhe përfaqësues të OJQ-ve dhe të grupeve avokuese të cilat merren me çështjet e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në këtë komunë. Në anën tjetër, gjithë procesi është organizuar nga “Programi për të Drejtat Civile” (CRP/K), projekti i mbështetur nga organizata Qendra e Këshillimit për shtetësi/të drejtat civile dhe të njeriut nga Republika Çeke - PORADNA, në kuadër të projektit *“Së bashku për përfshirjen sociale në Kosovë”*, mbështetur edhe nga Ministria e Punëve të Jashtme të Republikës Çeke për Promovimin e Programit për Tranzicion”. Procesi i hartimit të Planit të prioriteteve për përfshirjen e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Komunën e Fushë Kosovës deri te miratimi i këtij dokumenti ka kaluar nëpër disa faza, nëpër të cilat janë zhvilluar aktivitete të ndryshme. Fazat në fjalë janë të përshkruara shkurtimisht në vijim:

Faza 1: Përgatitja. Gjatë kësaj faze përfaqësuesit e Projektit kanë vendosur kontaktet me Komunën e Fushë Kosovës dhe kanë nënshkruar Marrëveshjen e Bashkëpunimit me Kryetarin e Komunës; Komuna e Fushë Kosovës ka caktuar personat që do të jenë pjesë e Grupit Punues për hartimin e planit të prioriteve. Projekti ka identifikuar dhe ka angazhuar konsulentët që do ta mbështesin procesin dhe do ta hartojnë planin e prioriteteve, si dhe janë mbajtur takime koordinuese mes anëtarëve të grupit punues dhe konsulentëve për planifikimin e datave të mbajtjes së punëtorive.

Faza 2: Analiza e gjendjes dhe përcaktimi i fushave. Projekti fillimisht ka organizuar një punëtor të përbashkët me grupet punuese për hartimin e planeve komunale të veprimit të komunave të ndryshme. Në këtë punëtori pjesëmarrësit janë informuar në detaje rreth procesit të hartimit të planeve lokale të veprimit dhe kanë përcaktuar fushat që do të përfshihen në kuadër të planit. Grupi Punues i Komunës së Fushë Kosovës ka diskutuar dhe është përcaktuar për fushat që do

të përfshihen në këtë plan të prioriteteve. Për nevoja të analizës së gjendjes për fushat që janë përfshirë në planin e veprimit është zhvilluar analiza ku bazuar në njohuritë e pjesëmarrësve, janë identifikuar sukseset, dobësitë, mundësitë dhe rreziqet për secilën nga fushat e përfshira në kuadër të këtij plani lokal të veprimit. Gjithashtu, gjatë kësaj faze janë mbledhur të dhëna dhe statistika zyrtare që kanë ofruar zyrtarët komunal të Komunës së Fushë Kosovës për të gjitha fushat e përfshira në këtë plan të veprimit.

Faza 3: Përcaktimi i objektivave dhe aktiviteteve të planit të veprimit. Për nevoja të përcaktimit të objektivave dhe përcaktimit të aktiviteteve të planit të veprimit, janë mbajtur dy punëtori një-ditore në Fushë Kosovë. Gjatë këtyre punëtorive, për secilën fushë që është përfshirë kuadër të Planit të prioriteteve për Përfshirjen e Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Komunën e Fushë Kosovës, janë identifikuar sfidat kryesore, janë përcaktuar objektivat strategjikë, janë përcaktuar rezultatet e pritshme, si dhe janë caktuar dhe përshkruar aktivitetet e parapara. Gjithashtu, gjatë kësaj punëtorie janë përcaktuar edhe treguesit për secilin objektiv, si dhe është bërë një identifikim dhe përshkrim i supozimeve dhe rreziqeve që ndikojnë në zbatimin e këtij plani të veprimit.

Faza 4: Planifikimi i buxhetit dhe planit të zbatimit. Për nevoja të planifikimit të buxhetit dhe të planit të zbatimit të këtij plani lokal të veprimit, është mbajtur një punëtori e veçantë në Fushë Kosovë. Në këtë punëtori është përcaktuar buxheti për të gjitha aktivitetet e parapara për periudhën katërvjeçare, duke e përcaktuar buxhetin e nevojshëm për secilin vit ndaras. Në këtë punëtori është detajuar plani i zbatimit i këtij plani lokal të veprimit për periudhën trevjeçare, duke i operacionalizuar aktivitetet e parapara dhe duke përcaktuar institucionet përgjegjëse për zbatimin e tyre.

Faza 5: Hartimi i dokumentit të planit të veprimit. Në bazë të dokumenteve të hartuara gjatë procesit, në përfundim të tij u hartua edhe drafti i Planit të prioriteteve për Përfshirjen e Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Komunën e Fushë Kosovës, i cili, pasi u shqyrtua nga grupi punues, mori formën e draftit përfundimtar. Plani i prioriteve për përfshirjen e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Komunën e Fushë Kosovës përmban katër (4) objektiva dhe një numër të madh të aktiviteteve të parapara për t'u realizuar nga viti 2018 deri në vitin 2021. Financimi i këtij plani parashihet të mbulohet nga Komuna e Fushë Kosovës, nga institucionet e nivelit qendror dhe nga donatorët tjerë të cilët angazhohen për mbrojtjen dhe fuqizimin e të drejtave të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë.

3. Analiza e gjendjes

Gjatë punëtorisë së mbajtur për hartimin e Planit të prioriteteve për Përfshirjen e Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Komunën e Fushë Kosovës, anëtarët e grupit punues për hartimin e këtij dokumenti kanë bërë analizën e gjendjes së komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në komunën e Fushë Kosovës duke u fokusuar në identifikimin e sfidave në katër fusha kryesore:

- Arsimi,

- Punësimi dhe mirëqenia sociale,
- Banimi,
- Shëndetësia.

Në punëtoritë e organizuara në të cilat kanë marrë pjesë përfaqësues dhe zyrtarë të ndryshëm të Komunës së Fushë Kosovës dhe përfaqësues të organizatave të ndryshme jo-qeveritare dhe të grupeve avokuese që punojnë me komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në këtë komunë është bërë një analizë e gjendjes ekzistuese e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në këtë komunë për këto katër fusha. Për analizën e gjendjes në këto katër fusha është përdorur anketa me qytetarë dhe mendimet, intervistat me zyrtarët përgjegjes të komunës së Fushë Kosovës, në mënyrë që të identifikohen sukseset, dobësitë, mundësitë dhe rreziqet. Analiza e tillë ka treguar se në mesin e punonjësve të Komunës së Fushë Kosovës dhe përfaqësuesve të OJQ-ve ekziston një shkallë e lartë e gatishmërisë për të identifikuar, përveç sukseseve dhe mundësive, edhe dobësitë dhe rreziqet e pranishme dhe kanë ofruar një bazë të kënaqshme për të analizuar shkaqet dhe pasojat e gjendjes jo të kënaqshme të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në komunën e Fushë Kosovës. Andaj, krahas dobësive dhe sukseseve që varen kryesisht nga niveli lokal, janë analizuar edhe faktorët e jashtëm që kanë ndikuar dhe vazhdojnë të ndikojnë në të ardhmen, si dhe në mënyrë objektive janë trajtuar dhe analizuar mundësitë dhe rreziqet. E gjithë analiza është bërë në grupe të vogla të punës, puna e të cilëve pastaj është shpalosur para grupit të gjerë dhe të gjitha çështjet janë diskutuar një nga një. Përveç të dhënave që kanë dalë nga analiza, anketa dhe takimet me pjestarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, është përgatitur edhe një formular i posaçëm për zyrtarët e Komunës së Fushë Kosovës, përmes të cilit janë kërkuar të dhëna dhe statistika zyrtare të nevojshme për analizën e gjendjes. Janë siguruar edhe të dhëna dhe statistika të tjera zyrtare nga OJQ-të, nga institucionet qendrore dhe nga dokumentet e ndryshme zyrtare publike, në mënyrë që të bëhet një analizë dhe prezantim sa më real dhe objektiv, i mbështetur në të dhëna.

3.1. Sfidat në arsim

- **Pjesëmarrja e ulët në arsimin parashkollor dhe arsimin fillor.** Është konstatuar pjesëmarrje e ulët e fëmijëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në arsimin parashkollor dhe fillor në institucionet arsimore në komunën e Fushë Kosovës.
- **Suksesi i dobët në mësim.** Është identifikuar si njëra nga problemet kryesore të fëmijëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në komunën e Fushë Kosovës.
- **Mosregjistrimi me kohë në klasën e parë.** Mosregjistrimi me kohë në klasën e parë i fëmijëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në komunën e Fushë Kosovës është një problem kronik i cili në mënyrë të vazhdueshme ndikon në suksesin dhe ambientimin e këtyre fëmijëve në procesin mësimor.
- **Braktisja e shkollës fillore.** Braktisja e arsimit fillor paraqitet si dukuri konstante si pasojë e shumë problemeve me të cilat ballafaqohen fëmijët dhe familjet e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në komunën e Fushë Kosovës.
- **Braktisja e shkollës së mesme.** Braktisja e shkollës së mesme paraqitet si dukuri konstante, madje edhe më e theksuar se braktisja e shkollës fillore, si pasojë e shumë problemeve me të cilat ballafaqohen fëmijët dhe familjet e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në komunën e Fushë Kosovës.

- **Prindërit pa shkollim adekuat dhe analfabetizmi.** Ky është një problem mjaft i theksuar në mesin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në komunën e Fushë Kosovës, i cili pamundëson ofrimin e mbështetjes së duhur për fëmijët dhe paraqet sfida serioze në drejtim të përfshirjes së plotë të fëmijëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në procesin mësimor në këtë komunë.
- **Rezultate të ulëta në testin e arritshmërisë dhe matures.** Për fëmijët që vijnë nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në komunën e Fushë Kosovës, rezultatet paraqesin faktor dekurajues për vazhdimin e shkollimit.
- **Mungesa e mbështetjes së qendrave mësimore.** Kjo paraqet sfida të madhe për integrimin e këtyre fëmijëve për shkak se këto qendra kanë për qëllim të plotësojnë njohuritë mësimore të fëmijëve.
- **Mungesa e mësimdhënësve nga radhët e komuniteteve.** Këtij problemi i paraprinë mungesa e kuadrove të kualifikuara që vijnë nga këto komunitete, sipas kritereve që janë të planifikuara në sistemin e arsimit.
- **Situata e rëndë socio-ekonomike.** Është sfida në vete për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian edhe në komunën e Fushë Kosovës dhe shkakton probleme të tëra në secilën familje të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian përfshirë edhe fëmijët e këtyre familjeve që ndjekin procesin mësimor.

3.2. Sfidat në punësim dhe mirëqenie sociale

- **Niveli i ulët i shkollimit.** Është njëra nga pengesat kryesore për punësimin dhe rritjen e mirëqenies së komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në komunën e Fushë Kosovës, pasi pjesëtarët e këtyre komuniteteve tradicionalisht kanë nivel më të ulët të shkollimit sesa pjesëtarët e komuniteteve tjera.
- **Mungesa e informatave rreth punësimit.** Është një sfida e cila vazhdimisht i përcjellë pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Komunën e Fushë Kosovës duke e pamundësuar konkurrimin apo përgatitjen e tyre në bazë të specifikave të tregut të punës.
- **Mosrespektimi i Ligjit të punës.** Është dukuri e zakonshme kur bëhet fjalë për pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në komunën e Fushë Kosovës (sikurse edhe në komunat tjera) duke mos nënshkruar kontrata pune, duke mos i paguar kontributet pensionale dhe duke mos i respektuar të drejtat themelore të të punësuarve.
- **Mungesa e dokumentave personale.** Mungesa e dokumentave personal, paraqet ende sfida për pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në komunën e Fushë Kosovës, pasi që nuk i posedojnë ato.

3.3 Sfidat në banim

- **Mungesa e të dhënave të sakta për nevojat e banimit.** Në mesin e familjeve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në komunën e Fushë Kosovës, mungesa e të dhënave është sfida themelore në drejtim të adresimit të nevojave emergjente dhe afatmesme të banimit tek familjet e këtyre komuniteteve.
- **Mungesa e fondeve qeveritare për mbështetjen e banimit.** Tek komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në komunën e Fushë Kosovës është evidente, pasi në pothuajse asnjë rast këto komunitete nuk janë në mesin e përfituesve.
- **Problemet me pronësi**-Mbi pronat të cilat jetojnë shumë familje të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Komunën e Fushë Kosovës është ndër sfidat më serioze e cila rëndon edhe më shumë gjendjen edhe ashtu të rënduar të banimit tek këto familje me ç'rast shumë familje të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian nuk kanë dokumentacion të duhur i cili dëshmon pronësinë e tyre mbi pronën në të cilin aktualisht jetojnë.
- **Mungesa e dokumenteve personale.** Edhe në rastin e banimit paraqitet mjaft sfiduese pasi pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Komunën e Fushë Kosovës nuk mund të pretendojnë të jenë përfitues të asistencës në mungesë të dokumentacionit personal përkatës.
- **Vendbanimet joformale.** Janë dukuri e shpeshtë për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë. Trajtimi i kësaj problematike kalon mandatin e Komunës së Fushë Kosovës dhe si e tillë kërkon trajtim nga institucionet qendrore të Kosovës.
- **Migrimi.** Migrimi dhe ndryshimi i shpeshtë i vendbanimit të familjeve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian po vështirëson zgjidhjen afatgjate të problemit të banimit të këtyre familjeve.

3.4. Sfidat në shëndetësi

- **Varfëria dhe pamundësia që të paguajnë shërbimet shëndetësore.** Një situatë e tillë ka ndikim negativ në parandimin e sëmundjeve dhe pranimin e shërbimeve shëndetësore në kohë për pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.
- **Paraqitja e vonshme.** Për të marrë trajtimin e duhur shëndetësor paraqitet si pasojë e drejtpërdrejtë e sfidave të lartshënuara duke ndikuar negativisht në shëndetin publik dhe individual të pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në komunën e Fushë Kosovës.
- **Të ushqyerit joadekuat.** Në një situatë të rënduar socio-ekonomike në të cilën ndodhen pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në komunën e Fushë Kosovës është evidente duke vështirësuar edhe më tutje gjendjen shëndetësore të tyre.
- **Mungesa e higjienës së përgjithshme dhe individuale.** Është sfidë e madhe tek pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në komunën e Fushë Kosovës duke marrë për bazë kushtet e jetesës së tyre.
- **Mungesa e kujdesit shtëpiak shëndetësor.** Është sfidë e cila hap rrugë për rritjen e problemeve ekzistuese në shëndetin publik dhe individual të pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në komunën e Fushë Kosovës.

ARSIMI

4. Objektivat strategjike

Plani Lokal i Veprimit për përfshirjen e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Komunëne Fushë Kosovës 2018-2021, ka përcaktuar katër objektiva strategjike: arsimit, punësimi dhemirëqenia sociale, banimi dhe shëndetësia. Krahas kësaj, është paraqitur nevoja e caktimit tënjë objektive të veçantë (gjendja e përgjithshme) përmes së cilës do të adresohen disa çështjeme karakter të përgjithshëm në interes të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Komunëne Fushë Kosovës. Objektivat e përcaktuar reflektojnë situatën e përgjithshme në Komunën eFushë Kosovës e cila është përshkruar në pjesën e analizës së gjendjes së këtij plani.

4.1.Arsimi

Në kuadër të Planit Lokal të Veprimit për përfshirjen e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Komunën e Fushë Kosovës 2018-2021, fusha e arsimit zë vend të posaçëm duke pas parasyshsituatën sa i përket fushës së arsimit në përgjithësi në Komunën e Fushë Kosovës.Ky plan parashehndërmarrjen e disa aktiviteteve (masave) që kanë për qëllim përmirësimin e gjendjes sëkomuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian të Komunës së Fushë Kosovës sa i përket fushës së arsimit,me theks të veçantë rritjen e nivelit të përfshirjes, zvogëlimin e rasteve të braktisjes dhepërmirësimin e suksesit të nxënësve të këtyre komuniteteve në të gjitha nivelet e arsimitparauniversitar.

Sfidat kryesore:

Pjesa dërrmuese e nxënësve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian të cilët jetojnë nëkomunën e Fushë Kosovës, procesin mësimor e vijojnë në gjuhën shqipe. Prandaj, trajtimi i problemeve me të cilat ballafaqohen nxënësit e komunitetit Rom, Ashkali dhe Egjiptian nëfushën e arsimit është mjaft delikat dhe si i tillë duhet të ketë trajtim të veçantë në kuadër tëkëtij plani. Qytetarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në komunën e Fushë Kosovës ballafaqohen me shumë sfida, ku ndër më të rëndësishmet janë:

- Nivel i ulët i përfshirjes së nxënësve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian nëarsimin parauniversitar në Komunën e Fushë Kosovës, posaçërisht në edukiminparashkollor dhe në shkollimin e mesëm të lartë.
- Nivel i ulët i informimit mbi rëndësinë e arsimit tek prindërit e komuniteteve rom,ashkali dhe egjiptian dhe mungesa e njohurive bazike për asistim të nxënësve nëhartimin e detyrave të shtëpisë.

- Braktisja e shkollimit nga nxënësit e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në arsimin fillor dhe të mesëm. Në funksion të adresimit të sfidave dhe zgjidhjes ose zvogëlimit të problemeve të përshkruar në fushën e arsimit për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian të komunës së Fushë Kosovës, është përcaktuar objektivi strategjik në vijim, i cili synohet të përmbushet gjatë periudhës së ardhshme katërvjeçare:

Objektivi Strategjik 1: Fuqizimi i pozitës së komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian përmes arsimit gjithëpërfshirës.

Rezultatet e pritshme

Për përmbushjen e objektivit strategjik të përcaktuar në këtë plan lokal veprimi për fushën e arsimit, parashihet arritja e rezultateve të pritshme si në vijim:

- **Rezultati 1.1:** tërritet pjesëmarrja e nxënësve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në komunën e Fushë Kosovës në arsimin parauniversitar.
- **Rezultati 1.2:** të zvogëlohet numri i rasteve të braktisjes së shkollimit nga nxënësit e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në komunën e Fushë Kosovës.
- **Rezultati 1.3:** të përmirësohet suksesi i nxënësve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në komunën e Fushë Kosovës.

Aktivitetet

Me qëllim të përmbushjes së objektivit strategjik dhe arritjes së rezultateve të pritshme të përcaktuara për fushën e arsimit është paraparë realizimi i disa aktiviteteve, të cilat do të prezantohen në vijim, së bashku me një përshkrim të shkurtër për secilin aktivitet.

Rezultati 1.1: Rritet pjesëmarrja e nxënësve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në komunën e Fushë Kosovës në arsimin parauniversitar.

Aktiviteti 1.1.1: Vetëdijësimi i prindërve mbi rëndësinë e vijimit të arsimit parauniversitar

Zyra për Komunitete dhe Kthim e Komunës së Fushë Kosovës, në bashkëpunim me Drejtorinë për Arsim të komunës së Fushë Kosovës dhe OJQ-të që angazhohen për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, si dhe me donatorët potencialë, do të organizojnë fushatë vetëdijësuese me prindërit dhe nxënësit e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian me qëllim të regjistrimit me kohë të nxënësve në arsimin parauniversitar. Këto fushata informuese për regjistrim bëhen në baza vjetore (në afatet e regjistrimit) dhe mund të realizohen përmes formave dhe mjeteve

tëndryshme, si: shpërndarja e fletëpalosjeve informuese nëpërshtëpi tëkomuniteteve, nëpër qendra mësimore, nëpër institucionetparashkollore dhe në shkolla; organizimi i takimeve informuese dhendihmuese me prindër nëpër qendra mësimore, institucione parashkollore dhe shkolla; radio emisione; përdorimi i rrjetevesociale, e tjetjere.

Aktiviteti 1.1.2: Identifikimi i fëmijëve për regjistrim në arsimimin parauniversitar

Zyra për Komunitete Kthim (ZKK) e Komunës së Fushë Kosovës, në bashkëpunim me Drejtorinë për Arsim (DA) të komunës së Fushë Kosovës, dhe OJQ-të që angazhohen për komunitetetrom, ashkali dhe egjiptian, do të angazhohet për identifikimin efëmijëve të moshës shkollore me qëllim të regjistrimit me kohë tëtyre në shkollë. Institucionet e mësipërme mund t'i ndihmojnë prindërve edhe rreth procedurave dhe dokumenteve të nevojshme për regjistrimin efëmijëve/nxënësve.

Rezultati 1.2: Zvogëlohet numri i rasteve të braktisjes së shkollimit nga nxënësit ekomuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në komunën e Fushë Kosovës.

Aktiviteti 1.2.1: Identifikohen dhe adresohen rastet e braktisjes së shkollimit nga nxënësit

DA e Komunës së Fushë Kosovës do të rris bashkëpunimin me shkollat dhe do të kërkoj nga ato që në baza të rregullta të raportojnë në DA për rastet kur nxënësit e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian e braktisin shkollimin. Bazuar në këto raportime, DA dhe ekipi përkatës për parandalimin e braktisjes së shkollimit, në bashkëpunim edhe me shkollat përkatëse, qendrat mësimore, grupet avokuese dhe përfaqësuesit e këtyre komuniteteve menjëherë do të realizojnë vizitanë familjet e nxënësve që braktisin shkollimin, do të identifikojnë shkaqet dhe arsyet e braktisjes dhe do të ndër marrin masat e nevojshme për rikthimin e tyre në procesin edukativo-arsimor.

Aktiviteti 1.2.2: DA dhe ZKK e Komunës së Fushë Kosovës do të mbulojnë shpenzimet e angazhimit për një mediator të arsimit që do të:

Angazhohet si mediatorë për arsim në kuadër të një OJQ-je lokale në fushëveprimtari të sëcilës do të jenë arsimi dhe nxënësit e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Roli i mediatorit do të konsistojë në angazhim të vazhdueshëm për identifikimin e rasteve potenciale për braktisje të shkollimit dhe në ndërmarrjen e hapave emergjent në koordinimit me palët e interesit me qëllim të parandalimit të braktisjes së arsimit.

Aktiviteti 1.2.3: Financimi i transportit

DA e Komunës së Fushë Kosovës do të mbulojë shpenzimet e transportit për nxënësit e fshatrave në zonat rurale me qëllim që ata/ato të vijojnë mësimin në shkollat filloredhe të mesme më të afërt në territorin e komunës së Fushë Kosovës.

Aktiviteti 1.2.4: Sigurimi i teksteve mësimore

DA e komunës së Fushë Kosovës, në bashkëpunim me ZKK-në, OJQ-të dhe donatorët potencial, do të siguroj tekstet mësimore përnxënësit e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian të cilët vijojnë mësimin.

Rezultati 1.3: Përmirësohet sukcesi i nxënësve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në komunën e Fushë Kosovës.

Aktiviteti 1.3.1: Kurse shtesë për regjistrim në shkollën e mesme

Nxënësit e komuniteteve rom, ashkali në vazhdimësi ballafaqohen me problemin e suksesit më të dobët në procesin arsimor krahasuar më bashkëmoshatarët e tyre. Një situatë e tillë paraqet pengesë serioze për këta nxënës në arritjen e synimit të tyre për regjistrim në shkollën e mesme në drejtimet e dëshiruara nga ata. DA e komunës së Fushë Kosovës në bashkëpunim me OJQ-të dhe donatorët potencial do të mundësojë organizimin e kurseve shtesë për nxënësit e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian me qëllim të regjistrimit të tyre në shkollat e mesme.

Aktiviteti 1.3.2: Mbështetje për pjesëmarrje në aktivitetet jashtëmësimore

DA e Komunës së Fushë Kosovës, në koordinim me ZKK-në (në përputhje me mundësitë e tyre financiare), OJQ-të dhe donatorët potencial, do të mbulojë shpenzimet e nevojshme për pjesëmarrjen e nxënësve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në aktivitetet e ndryshme të cilat organizohen në kuadër të procesit arsimor në Komunën e Fushë Kosovës përfshirë, garat e ndryshme sportive, kuizet e diturisë, ekskursionet e ndryshme brenda apo jashtë vendit etjera.

Aktiviteti 1.3.3: Përkrahje për Qendrat Mësimore të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian

DA e Komunës së Fushë Kosovës, në koordinim me ZKK-në, OJQ-të dhe donatorët potencial do të ofrojë përkrahje adekuatë për funksionimin e qendrave mësimore ekzistuese të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në territorin e Komunës së Fushë Kosovës.

Aktiviteti 1.3.4: Ndarja e bursave

Me qëllim të nxitjessë arsimimit të nxënësve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, me ndihmën e OJQ-ve dhe donatorëve potencial do të sigurohet fond i bursave përmes së cilës do të mbështeten nga 20 nxënës të shkollave të mesme, dhe 5 studentë në arsimin e lartë, pasi që DA dhe ZKK nuk posedojnë fond të veçantë të bursave për nxënës dhe studentë.

Rreziqet

Faktorët që mund ta rrezikojnë arritjen e këtij objektivstrategjik janë:

- Qendrat Mësimore mund ta reduktojnë ose ta ndërprejnë fare aktivitetin e tyre për shkak të mospërkrahjes financiare nga donatorët aktualë.

4.2. Punësimi dhe mirëqenia sociale

Niveli i lartë i papunësisë në mesin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në komunën e Fushë Kosovës është shkaktar i shumë problemeve socio-ekonomike për këto komunitete. Në një rëndësi anë punësimi është i lidhur dhe i ndikuar drejtpërdrejt nga niveli i shkollimit, ndërsa në anën tjetër është i lidhur dhe ndikon drejtpërdrejt në mirëqenien sociale të këtyre komuniteteve. Rrjedhimisht, rritja e nivelit të punësimin në mesin e këtyre komuniteteve është shumë me rëndësi, prandaj dhe është vendosur që fusha e dytë e këtij Plani Lokal të Veprimit të jetë punësimi, duke pas parasysh që nevoja për punësim i nxitë pjesëtarët e këtyre komuniteteve që t'i kushtojnë më shumë rëndësi arsimimit dhe në të njëjtën kohë punësimi i kontribuon përmirësimit të mirëqenies sociale të këtyre komuniteteve. Ky plan veprimi parasheh ndërmarrjen e disa aktiviteteve që kanë për qëllim përmirësimin e gjendjes së komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian të Komunës së Fushë Kosovës sa i përket fushës së punësimin dhe mirëqenies sociale, posaçërisht në rritjen e nivelit të punësimin, kualifikimin e kuadrove dhe përmirësimin e mirëqenies sociale të këtyre komuniteteve në Komunën e Graçanicës.

Në funksion të adresimit të sfidave dhe zgjidhjes ose zvogëlimit të problemeve të përshkuara në fushën e punësimin dhe mirëqenies sociale të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në komunën e Fushë Kosovës, është përcaktuar objektivi strategjik në vijim, i cili synohet të përmbushet gjatë periudhës së ardhshme trevjeçare:

Objektivi Strategjik 2: Përmirësimi i gjendjes ekonomike dhe sociale të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.

Sfidat kryesore

Sikur edhe në fushën e arsimit, ashtu edhe sa i përket punësimin dhe mirëqenies sociale, komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian të komunës së Fushë Kosovës ballafaqohen me shumë sfida. Në pamundësi që të gjitha këto sfida të adresohen dhe të zgjidhen brenda periudhës që mbulon ky plan veprimi, në vijim do të prezantohen shkurtimisht vetëm disa prej tyre, ato më kryesoret, të cilat synohen të adresohen nga ky plan lokal i veprimit:

- Mungesa e arsimit adekuat, niveli i lartë i papunësisë në radhët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në komunën e Fushë Kosovës.
- Mungesa e qendrës për aftësim profesional në komunën e Fushë Kosovës.
- Mungesa e dokumenteve personale dhe mungesa e informatave mbi tregun e punës.
- Mungesa e informatave mbi skemat sociale.

Rezultatet e pritshme

Për përmbushjen e objektivit strategjik të përcaktuar në këtë plan lokal veprimi për fushën e punësimin dhe mirëqenies sociale parashihet arritja e rezultateve të pritshme në vijim:

- Rezultati 2.1: Rritet niveli i punësimit në radhët e pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në komunën e Fushë Kosovës.
- Rezultati 2.2: Rritet numri i kuadrove të kualifikuara nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në komunën e Fushë Kosovës.
- Rezultati 2.3: Përmirësohet gjendja socio-ekonomike dhe pjesëmarrja në skemat sociale të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në komunën e Fushë Kosovës.

Aktivitetet

Me qëllim të përmbushjes së objektivit strategjik dhe arritjes së rezultateve të pritshme të përcaktuara për fushën e punësimit dhe mirëqenies sociale është paraparë realizimi i disa aktiviteteve (të grupuara sipas rezultateve të pritshme), të cilat do të prezantohen në vijim, së bashku me një përshkrim të shkurtër për secilin aktivitet.

Rezultati 2.1: Rritet niveli i punësimit nga radhët e pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në komunën e Fushë Kosovës.

Aktiviteti 2.1.1: Ngritja e vetëdijesimit për rëndësinë e vetëpunësimit

Komuna e Fushë Kosovës do të organizojë fushatë për vetëdijesimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian për rëndësinë e vetëpunësimit. Fushata do të përfshijë shtypjen dhe shpërndarjen e broshurave; organizimin e takimeve informuese/konsultuese, fushatë mediale për vetëpunësim, etjera.

Aktiviteti 2.1.2: Subvencionimi i iniciativave për vetëpunësim

Komuna e Fushë Kosovës do të subvencionojë iniciativat e themelimit të mikro-bizneseve personale/familjare me qëllim të krijimit të vendeve të punës, përmes iniciativave të vetëpunësimit të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Në këtë mënyrë, Komuna e Fushë Kosovës në bashkëpunim edhe me OJQ-të dhe donatorët potencial, për çdo vit do të mbështet iniciativat për vetëpunësim të familjeve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian që jetojnë në territorin e komunës së Fushë Kosovës.

Aktiviteti 2.1.3: Organizohet panairi i punësimit

Komuna e Fushë Kosovës, në bashkëpunim me OJQ-të, donatorët potencial dhe afaristët të cilët veprimtarinë e tyre afariste e zhvillojnë në këtë komunë, do të organizojnë panairë të punësimit. Në fokus të panairit të punësimit do të jetë prezantimi i potencialit të punësimit në mesin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian si dhe ndërmjetësimi në vendosjen e komunikimit/bashkëpunimit në mes të të interesuarve për punësim nga radhët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian dhe afaristëve të komunës së Fushë Kosovës.

Rezultati 2.2: Rritet numri i kuadrove të kualifikuara nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në komunën e Fushë Kosovës.

Aktiviteti 2.2.1: Themelimi i Qendrës për Aftësim Profesional

Komuna e Fushë Kosovës do të iniciojë procedurat ligjore në Ministrinë përkatëse për themelimin e një Qendre për Aftësim Profesional në territorin e komunës së Fushë Kosovës. Përmes hapjes së Qendrës për Aftësim Profesional do t'u mundësohej banorëve të komunës së Fushë Kosovës në përgjegjësi, dhe të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në veçanti, që të jenë pjesë e programeve specifike për aftësim profesional.

Aktiviteti 2.2.2: Ofrimi i trajnimeve për aftësim profesional

Komuna e Fushë Kosovës për çdo vit do të ofrojë mbështetje për pesë persona nga radhët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian për të mundësuar pjesëmarrjen e tyre në trajnimet e ofruara nga Qendra e Aftësimin Profesional.

Rezultati 2.3: Përmirësohet gjendja socio-ekonomike dhe pjesëmarrja në skemat sociale e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Komunën e Fushë Kosovës.

Aktiviteti 2.3.1: Përfitim i barabartë nga subvencionet

Komuna e Fushë Kosovës do të sigurohet që nga subvencionet e ndara nga Komuna apo nga donatorët e jashtëm përfitues të jenë të gjitha komunitetet që jetojnë në territorin e komunës së Fushë Kosovës në bazë të përqindjes së popullatës. Komuna e Fushë Kosovës do të merr veprime konkrete për të siguruar se edhe pjesëtarë të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian janë përfituese të subvencioneve të ndara.

Rreziqet

Faktorët që mund ta rrezikojnë arritjen e këtij objektivit strategjik janë:

- Dështojnë iniciativat për vetëpunësim të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.
- Bizneset nuk shprehin interesim për punësimin e pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.
- Pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian nuk marrin pjesë në programet e aftësimin profesional.

4.3. Banimi

Strategjia për përfshirjen e komuniteteve rom dhe ashkali në shoqërinë kosovare 2017-2022, e aprovuar nga Qeveria e Kosovës, si njëri nga elementet kryesore me ndikim për përfshirjen e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian e ka cilësuar fushën e banimit, përkatësisht, strehimin

e qëndrueshëm. Rëndësia e banimit dhe e strehimit të qëndrueshëm është qenësore edhe për përfshirjen e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian duke bërë që kjo të jetë njëra nga shtyllat e rëndësishme të Planit Lokal të Veprimit për përfshirjen e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Komunën e Fushë Kosovës 2018-2021.

Numër i madh i familjeve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian që jetojnë në territorin e komunës së Fushë Kosovës ballafaqohen me problemin esencial të banimit. Shkaqet e një problem të tillë padyshim se është gjendja e rënduar ekonomike dhe sociale e këtyre familjeve. Ndërkohë që pasojat e mungesës së banimit dhe strehimit të qëndrueshëm reflektohen në mënyrë të drejtpërdrejtë në cilësinë e jetës dhe shëndetit të tyre.

Plani Lokal i Veprimit për përfshirjen e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Komunën e Fushë Kosovës 2018-2021, parasheh ndërmarrjen e disa aktiviteteve (masave) që kanë për qëllim përmirësimin e gjendjes së komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian të Komunës së Fushë Kosovës sa i përket fushës së banimit, me theks të veçantë sigurimin e strehimit për familjet e pastreha, sigurimin e banimit të qëndrueshëm për disa familje dhe adresimin e vendbanimeve joformale ku jetojnë këto komunitete.

Në funksion të adresimit të sfidave dhe zgjidhjes ose zvogëlimit të problemeve të përshkruara në fushën e banimit dhe strehimit të qëndrueshëm për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian të Komunës së Fushë Kosovës, është përcaktuar objektivi strategjik në vijim, i cili synohet të përmbushet gjatë periudhës së ardhshme katërvjeçare:

Objektivi Strategjik 3: Krijimi i kushteve për banim adekuat për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian.

Sfidat kryesore

Komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian të komunës së Fushë Kosovës ballafaqohen me shumë sfida sa i përket fushës së banimit. Në pamundësi që të gjitha këto sfida të adresohen dhe të zgjidhen brenda një periudhës që mbulon ky plan i veprimit, në vijim do të prezantohen shkurtimisht vetëm disa prej tyre, ato më kryesoret, të cilat synohen të adresohen nga ky plan lokal i veprimit:

- Mungesa e të dhënave mbi nevojat reale dhe mospërfshirja e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në skemat e kaluara.
- Migrimi/lëvizja e shpeshtë e familjeve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në komunën e Fushë Kosovës.

- Mungesa e dokumenteve personale, pronësore dhe ekzistenca e vendbanimeve joformale ku jetojnë pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në komunën e Fushë Kosovës.

Rezultatet e pritshme

Për përmbushjen e objektivit strategjik të përcaktuar në këtë plan lokal veprimi për fushën e banimit parashihet arritja e rezultateve të pritshme në vijim:

- Rezultati 3.1: Sigurohet banim për familjet e pastrehë të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në komunën e Fushë Kosovës.

Aktivitetet

Me qëllim të përmbushjes së objektivit strategjik dhe arritjes së rezultateve të pritshme të përcaktuara për fushën e banimit dhe strehimit të qëndrueshëm është paraparë realizimi i disaaktiveteve (të grupuara sipas rezultateve të pritshme), të cilat do të prezantohen në vijim, sëbashku me një përshkrim të shkurtër për secilin aktivitet.

Rezultati 3.1: Sigurohet banim për familjet e pastrehë të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në komunën e Fushë Kosovës.

Aktiviteti 3.1.1: Përfitim ngandërtimet

Komuna e Fushë Kosovës do të merr masa të posaçme për t'u siguruar nga banesat kolektive të ndërtuara për kategoritë sociale në bazëtë përqindjes së popullatës përfitojnë edhe familjet e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Komuna e Fushë Kosovës do të kujdeset për zbatimin e këtij parimi edhe në rastet kur projektet e tilla realizohen nga institucione qendrore apo donatorë.

Rreziqet

Faktorët që mund ta rrezikojnë arritjen e këtij objektivit strategjik janë:

- Institucionet qendrore/donatorët të cilët ndërtojnë objekte të banimit kolektiv për kategoritë e caktuara sociale e shpërfillin parimin e Komunës së Fushë Kosovës për përfitim të banesave për të gjitha komunitetet që jetojnë në territorin e komunës së Fushë Kosovës varësisht me përqindjen e popullatës së përgjithshme.

4.4. Shëndetësia

Problemet e panumërta me të cilat ballafaqohen familjet e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në komunën e Fushë Kosovës në mënyrë të paevitueshme ndikojnë edhe në shëndetin e kësaj kategorie të popullatës së Fushë Kosovës Pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian ballafaqohen me probleme shëndetësore të cilat janë rezultat i drejtpërdrejtë i kushteve të rënda jetësore dhe gjendjes së rëndë ekonomike dhe sociale. Plani Lokal i Veprimit për përfshirjen e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Komunën e Fushë Kosovës 2018-2021, trajton problematikën e shëndetësisë së pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Komunën e Fushë Kosovës duke tentuar që të ndikojë në përmirësimin e gjendjes aktuale në fushën e shëndetësisë dhe ruajtjen e shëndetit publik të kësaj pjese të shoqërisë.

Plani Lokal i Veprimit për përfshirjen e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Komunën e Fushë Kosovës 2018-2021, parasheh ndërmarrjen e disa aktiviteteve (masave) që kanë për qëllim përmirësimin e gjendjes së komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian të Komunës së Fushë Kosovës sa i përket fushës së shëndetësisë, posaçërisht vaksinimit të gjithë fëmijëve, ngritjen e nivelit të edukimit shëndetësor dhe përmirësimin e kushteve të jetesës. Në funksion të adresimit të sfidave dhe zgjidhjes ose zvogëlimit të problemeve të përshkuara për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian të Komunës së Fushë Kosovës është përcaktuar objektivi strategjik në vijim, i cili synohet të përmbushet gjatë periudhës së ardhshme trevjeçare:

Objektivi Strategjik 4: Përmirësimi i qasjes në shërbime shëndetësore dhe i shëndetit publik të pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.

Sfidat kryesore

Problemet në fushën e shëndetësisë për pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian që jetojnë në komunën e Fushë Kosovës janë të ngjashme me problemet me të cilat pjesëtarët e këtyre komuniteteve ballafaqohen edhe në pjesë tjera të Kosovës. Ky plan i veprimit përqendrohet në trajtimin e problemeve më të përgjithshme në fushën e shëndetësisë me të cilat ballafaqohen pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian duke përfshirë:

- Të ushqyerit joadekuat, mungesa e higjienës dhe mungesa e kujdesit shtëpiak shëndetësor.
- Mungesa e informimit dhe edukimit shëndetësor rreth çështjeve jetike shëndetësore.

Rezultatet e pritshme

Për përmbushjen e objektivit strategjik të përcaktuar në këtë plan lokal veprimi për fushën e shëndetësisë parashihet arritja e rezultateve të pritshme në vijim:

- Rezultati 4.1: Komuna e Fushë Kosovës rrit angazhimin duke përmirësuar kujdesin shëndetësor ndaj pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.
- Rezultati 4.2: Ritet niveli i vetëdijesimit mbi kujdesin ndaj shëndetit publik dhe personal në mesin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.

Aktivitetet

Me qëllim të përmbushjes së objektivit strategjik dhe arritjes së rezultateve të pritshme të përcaktuara për fushën e shëndetësisë është paraparë realizimi i disa aktiviteteve (të grupuara sipas rezultateve të pritshme), të cilat do të prezantohen në vijim, së bashku me një përshkrim të shkurtër për secilin aktivitet.

Rezultati 4.1: Komuna e Fushë Kosovës rrit angazhimin duke përmirësuar kujdesin shëndetësor ndaj pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.

Aktiviteti 4.1.1: Kujdesi shëndetësor shtëpiak

Komuna e Fushë Kosovës kujdeset për funksionalizimin e plotë të sistemit të kujdesit shëndetësor shtëpiak dhe për funksionimin eplotë të saj në vendbanimet në të cilat kryesisht jetojnë familjet e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.

Aktiviteti 4.1.2: Kontrolli shëndetësor i nxënësve

Komuna e Fushë Kosovës çdo vit organizon kontroll sistematik shëndetësor të nxënësve në shkollat fillore të cilat veprojnë në territorin e Komunës. Komuna kujdeset që nxënësit e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian të jenë pjesë e kontrollit sistematik shëndetësor.

Aktiviteti 4.1.3: Vaksinimi i rregullt

Komuna e Fushë Kosovës merr masa dhe sigurohet që të gjithë fëmijët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian vaksinohen në kohë të duhur.

Aktiviteti 4.1.4: Analiza laboratorike pa pagesë

Komuna e Fushë Kosovës ofron kryerjen e analizave pa pagesë për përfituesit e skemës sociale që vijnë nga radhët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.

Rezultati 4.2: Ritet e nivelit të vetëdijesimit mbi kujdesin ndaj shëndetit publik dhe personal në mesin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.

Aktiviteti 4.2.1: Ngritja e vetëdijesimit

Komuna e Fushë Kosovës do të organizojë fushatë për vetëdijesimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian për rëndësinë mbrojtjes së shëndetit publik dhe personal. Fushata do të përfshijë shtypjen dhe shpërndarjen e broshurave, organizimin e takimeve informuese/konsultuese dhe fushatë mediale për vetëpunësim, etjera.

Aktiviteti 4.2.2: Angazhimi i mediatorit shëndetësor

Komuna e Fushë Kosovës do të angazhojë një punonjës të saj i cili do të kryej detyrën e mediatorit, i cili në kuadër të fushëveprimtarisë do të ketë shëndetësinë dhe komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian. Roli i mediatorit do të konsistojë në angazhim të vazhdueshëm për identifikimin e rasteve me probleme shëndetësore, informimin e institucioneve shëndetësore për këto raste dhe adresimin e atyre rasteve në institucionet shëndetësore përkatëse.

Rreziqet

Faktorët që mund të rrezikojnë arritjen e këtij objekti strategjik janë:

- Interesimi i ulët i komuniteteve për vijimin e aktiviteteve informuese dhe edukuese përrëndësinë e shëndetit.

4.5. Çështjet e ndërlidhura

Plani Lokal i Veprimit për përfshirjen e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në komunën e Fushë Kosovës 2018-2021, parasheh ndërmarrjen e disa aktiviteteve (masave) që kanë për qëllim sigurimin e të dhënave dhe statistikave të rëndësishme për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian të Komunës së Fushë Kosovës sa i përket fushës së arsimit, punësimit dhe mirëqenies sociale, shëndetësisë dhe banimit, si dhe ngritjen e nivelit të vetëdijesimit të pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në komunën e Fushë Kosovës për aspekte të rëndësishme që ndikojnë në jetën dhe perspektivën e tyre.

Në funksion të adresimit të sfidave dhe zgjidhjes ose zvogëlimit të problemeve të përshkuara në fushën e banimit dhe strehimit të qëndrueshëm për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian të Komunës së Fushë Kosovës është përcaktuar objekti strategjik në vijim, i cili synohet të përmbushet gjatë periudhës së ardhshme trevjeçare:

Objekti Strategjik 5: Përmirësimi i gjendjes së përgjithshme të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Komunën e Fushë Kosovës.

Sfidat kryesore

Komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian të Komunës së Fushë Kosovës ballafaqohen me shumë sfida e probleme sa i përket fushës së arsimit, punësimit dhe mirëqenies sociale, shëndetësisë dhe banimit, të cilat janë identifikuar dhe prezantuar paraprakisht në kuadër të fushës përkatëse. Ndërsa, këtu do të përmenden dy aspekte të tjera që lidhen me të gjitha fushat, të cilat kërkojnë qasje dhe trajtim të integruar dhe të cilat synohen të adresohen nga ky plan lokal i veprimit:

- Mungesa e të dhënave dhe statistikave për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në komunën e Fushë Kosovës për të gjitha fushat dhe aspektet e rëndësishme të këtyre komuniteteve.

- Niveli jo shumë i kënaqshëm i vetëdijesimit të pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Komunën e Fushë Kosovës për aspekte të rëndësishme që ndikojnë në jetën dhe perspektivën e tyre.

Rezultatet e pritshme

Për përmbushjen e objektivit strategjik të përcaktuar në këtë plan lokal veprimi parashihet arritja e rezultateve të pritshme në vijim:

- Rezultati 5.1: Rritet vetëdijesimi i pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Komunën e Fushë Kosovës për aspekte të rëndësishme që ndikojnë në jetën dhe perspektivën e tyre.
- Rezultati 5.2: Rritet niveli i përfshirjes në shoqëri i pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Fushë Kosovës veçanti dhe në Republikën e Kosovës në përgjithësi.

Aktivitetet

Me qëllim të përmbushjes së objektivit strategjik dhe arritjes së rezultateve të pritshme të përcaktuara për fushën e shëndetësisë është paraparë realizimi i disa aktiviteteve (të grupuara sipas rezultateve të pritshme), të cilat do të prezantohen në vijim, së bashku me një përshkrim të shkurtër për secilin aktivitet.

Rezultati 5.1: Mblidhen të dhëna për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në Komunën e Fushë Kosovës për të gjitha fushat dhe aspektet e rëndësishme të këtyre komuniteteve.

Aktiviteti 5.1.1: Analiza e gjendjes

Komuna e Fushë Kosovës, në bashkëpunim me OJQ-të dhe donatorët, ndërmerr fushatë të gjerë për analizën e gjendjes së saktë të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian të cilët jetojnë në territorin e komunës së Fushë Kosovës. Analiza do të përfshijë të dhëna me interes të përgjithshëm duke përfshirë por duke mos u kufizuar në nivelin e furnizimit me dokumentet e gjendjes civile, të dhënat lidhur me arsimimin, nxënësit, shëndetin individual, gjendjen e banimit, statusin social, punësimin dhe të dhëna tjera relevante.

Aktiviteti 5.1.2: Dokumentet e gjendjes civile

Komuna e Fushë Kosovës do të organizojë fushatë për vetëdijesimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian për rëndësinë furnizimit me dokumentet personale dhe dokumentet tjera të gjendjes civile. Fushata do të përfshijë shtypjen dhe shpërndarjen e broshurave, organizimin e takimeve informuese/konsultuese, fushatë mediale për vetëpunësim, etj. Krahas kësaj, Komuna e Fushë Kosovës do të lirojë pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian nga pagesa e taksave komunale për nxjerrjen e dokumenteve të gjendjes civile për vitet 2020 dhe 2021.

Rezultati 5.2: Rritet vetëdijesimi i pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Komunën e Fushë Kosovës për aspekte të rëndësishme që ndikojnë në jetëndhe perspektivën e tyre.

Aktiviteti 5.2.1: Emisione në gjuhën rome

Komuna e Fushë Kosovës në bashkëpunim me OJQ-të, donatorët dhe mediat lokale siguron realizimin e emisioneve të rregullta në gjuhën rome në radio lokale. Një veprim i tillë i Komunës së Fushë Kosovës është në funksion të respektimit të vendimit të Kuvendit të Komunës së Fushë Kosovës për njohjen e statusit të gjuhës rome si gjuhë në përdorim zyrtar në këtë komunë. Emisionet në gjuhën rome do të shërbejnë për informimin e pjesëtarëve të komuniteteve mbi zhvillimet lokale, për realizimin efikas të fushatave të vetëdijesimit dhe për çështje tjera me interes të përgjithshëm.

Aktiviteti 5.2.2: Vetëdijesim për mbrojtjen e ambientit

Pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian shpesh detyrohen të jetojnë në ambiente jo të pastra dhe në ambiente të cilat mund të rrezikojnë seriozisht shëndetin e tyre. Në shumë raste, krijimit të një ambienti të tillë i kontribuojnë edhe vetë pjesëtarët e komuniteteve. Komuna e Fushë Kosovës do të organizojë fushatë për vetëdijesimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian për rëndësinë e mbrojtjes së ambientit. Fushata do të përfshijë shtypjen dhe shpërndarjen e broshurave, organizimin e takimeve informuese/konsultuese dhe kampanja mediale për vetëpunësim etj.

Rezultati 5.3: Rritet niveli i përfshirjes në shoqëri i pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.

Aktiviteti 5.3.1: Përdorimi i gjuhës rome, si gjuhë në përdorim zyrtar

Komuna e Fushë Kosovës duhet të merr vendim që sipas ligjit për përdorimin e gjuhëve në Kosovë gjuhës rome t'ja pranojë statusin e gjuhës në përdorim zyrtar në institucionet komunale. Megjithatë, Komuna e Fushë Kosovës në të ardhem mund të ballafaqohet me shumë probleme në synimin e saj për jetësimin dhe zbatimin e plotë të këtij vendimi. Komuna e Fushë Kosovës do të ndërmer masat e nevojshme për zbatimin e plotë të vendimit të saj.

Aktiviteti 5.3.2: Organizohen kurse të gjuhës

Komuna e Fushë Kosovës në bashkëpunim me OJQ-të dhe donatorët potencial do të organizojë kurse të gjuhës për nxënësit e interesuar të shkollave fillore dhe të mesme. Për fëmijët e interesuar do të ofrohen kurse të gjuhës serbe, shqipe dhe kurse të gjuhës rome.